

Përkujtojmë njëvjetorin e jetëndërrimit të Kryepiskopit të lumur Anastas



Me rastin e njëvjetorit të jetëndërrimit të Kryepiskopit të lumur Anastas, nën kujdesin e Fortlumluturisë së Tij Joanit, Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe Gjithë Shqipërisë, Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës i Kolegjit Universitar “Logos” organizon Konferencë Ndërkombëtare me temë: “Kryepiskopi Anastas, madhështia në të bërët dhe në të mësuarit” (Mt.15:19).

Konferenca do të zhvillojë punimet nga datat 22-24 janar 2026.

Ditën e diel, më 25 janar 2026, në Katedralen “Ngjallja e Krishtit” në Tiranë do të kryhen Mëngjesorja dhe Liturgjia Hyjnore, ora 7:30 – 10:30, në drejtimin e Fortlumluturisë së Tij, Kryepiskopit Joan, së bashku me të gjithë anëtarët e Sinodit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Më pas, ora 10:30, do të kryhet Shërbesa e Përshpirtjes në përkujtim të Kryepiskopit të lumur Anastas.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)